



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRIN

Nr./Br. 58473/24

Nr. i fq./ Nr. sh. - 2 -



Data/ Datum: 09.12.2024

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRISË

DATE/A	09.12.2024
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetari të Komunës z. Ferit Idrizi 
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DBZHR-së z. Ergin Sungur 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PËR APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: " Subvencionimi i mbarshtruesve të buallicave".

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve mbarshtrues të buallicave të Komunës së Vushtrisë se Komuna e Vushtrisë-Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë 2024 do të subvencionojë fermerët që mbarshtrajnë buallica në shumën prej 100 €/ krerë.

II. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrisë;
- Aplikues për pagesa direkte 2024;
- Të mbarshtrrojë;
 - Pesë (5) e më shumë krerë buallica;

III. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Konfirmimi i bankës për posedim të Llogarisë bankare;
3. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV për vitin 2024;
4. Vendimin për numrin e buallicave të aprovuar për pagesë nga ana e AZHB-së për vitin 2024;

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: **11.12.2024. – 27.12. 2024.**

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit çdo ditë pune.